VENDIM
Nr.342, datë 12.4.2006

PËR PËRCAKTIMIN E DETYRIMIT TË ANTA SHA-SË, PËR KRYERJEN E PAGESAVE, QË RRJEDHIN NGA ANËTARËSIMI NË EUROCONTROL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8821, datë 15.10.2001 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare të Eurocontrol-it",me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. ANTA sh.a., nga të ardhurat e shërbimit të mbikalimit ajror, duhet të derdhë, çdo vit, në Agjencinë e Eurocontrol-it, kontributin e anëtarësimit, në emër të shtetit shqiptar.

2. ANTA sh.a., nga të ardhurat e shërbimit të mbikalimit ajror, duhet të derdhë, çdo vit, në Buxhetin e Shtetit, koston e DPAC-së për veprimtarinë e mbikalimit, e cila është përfshirë në çmimin për njësi, që arkëtohet nga Eurocontrol-i. Kostoja e DPAC-së për veprimtarinë e mbikalimit të përcaktohet sipas rregullave në marrëveshjet me Eurocontrolin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha